



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 101 Prot.

Gramsh, më 12.01.2026

SHPALLJE PËR POZICION TË LIRË PUNE
NË STRUKTURËN E POLICISË SË BASHKISË GRAMSH

Në zbatim të Ligjit nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake” Bashkia Gramsh shpall pozicionin e vendit të lirë të punës për:

- **2 (dy) punonjës të policisë bashkiake.**

Misioni

Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, mirëadministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Detyrat edhe përgjegjësitë

1. Siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
2. Parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administartive përmes inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brënda territorit të juridiksionit të saj;
3. Merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
4. Kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit.
5. Bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikqyrjen e sigurisë, ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteteve brenda territorit të juridiksionit të saj;
6. Merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
7. Merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe atyre që administrohen nga ana e saj;

8. Mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
9. Bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;
10. Siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;
11. Mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtaritë e tyre;
12. Siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirave publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjes së mbeturinave dhe mbrojtjen e lulishteve publike;
13. Vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
14. Garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandiste në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

Kushtet e punës

Shërbimi i Policisë Bashkiake i kryen detyrat duke qenë në gadishmëri 16 orë në ditë me ndarje në 2 turne, për të vepruar në çdo rast.

Pagat dhe përfitimet

Punonjësi i shërbimit të Policisë Bashkiake, përfiton :

a) pagë mujore, dhe shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi;

Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të policisë bashkiake, përcaktohen me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Kriteret e domosdoshme për zgjedhjen e aplikantëve:

Për pranimin në pozicionin e punonjësit Polic bashkiak, niveli bazë, në bashki, kandidati duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e)Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- f) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- g) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

Dokumentacioni mënyra dhe afati i dorëzimi:

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 19.01.2026

1. Dokumentat që duhet të paraqiten janë:
 - b) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
 - c) Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
 - d) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave (e noterizuar). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
 - e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - h) Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
 - i) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (nëse ka);
 - j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - k) Leje drejtimi për kategorinë B;
 - l) Vërtetim besueshmërie;
 - m) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

1. Mungesa e njërit prej dokumentave të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumentave sjell skualifikimin e kandidatit.

Në datën **21.01.2026** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Gramsh do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e aplikimit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotëson kriteret e aplikimit do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Gramsh, nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë e tyre mbi:

- Ligjin nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”
- Rregulloren e Policisë së Bashkisë .

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- 60 pikë vlerësimi me shkrim;
- 20 pikë testimi fizik;

Kandidati që merr më pak se 60 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **22.01.2025** , ora **10:00** në mjediset e sallës së mbledhjeve të Bashkisë Gramsh.

KRYETARI

BESION AJAZI

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- 60 pikë vlerësimi me shkrim;
- 20 pikë testimi fizik;

Kandidati që merr më pak se 60 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **22.01.2026** , ora **11:00** në mjediset e sallës së mbledhjeve të Bashkisë Gramsh.

KRYETARI
BESION AJAZI

